

AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE " SELAMI "sh.p.k.

NENI 1

Me vullnetin e lire te ortakut

SHKELQIM SELAMI i atelindjes 1967 lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore

U krijua shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar " SELAMI SH P.K.

NENI 2

Shoqeria do te kete seline e saj NE "Kuzumbaba " Vlore . me vendim te ortakut te vetem mund te ngrihen e dhe dege , filiale apo seli ne vende te tjera .

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete per 20(njezete) vjet por me vendim te ortakut te vetem ky afat mund te zgjatet ose shoqeria mund te priset parakohe.

NENI 4

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga (100 000) mije leke , i cili eshte teresisht kapital financiar dhe i depozituar ne banke ne emer te saj .

I gjithë kapitali themeltar zoterohet nga ortaku i vetem nemasen 100% i cili ka te drejte ta tjetersojne kete kapital , te shtojne apo pakesoje ate deri ne kufijte e percaktuar nga ligja .

NENI 5

Objekti i veprimtarise se shoqeris do te jete :

- Prodhimi i artikujve ushqimore industriale
- Ngritja e linjave te prodhimit per to
- Tregetimin magazinimin e mallrave industriale ushqimore , elektrike , hidraulike, veshmbathje , mobilieri, pjese kembimi te ndryshme , hidrosanitare , kancelari
- Import exportin artikujve si me siper
- Hapjen njesive per shitjen e tyre
- Hoteleri ,bar , restorante

- ndertim dhe r Rikostruksion banesash etj .
- lojra fati .

NENI 6

Organi i vetem drejtues i shoqerise eshte ortaku i vetem
Administator I shoqerise do te jete SHKELQIM Selami I
datelindjes 1967 'lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore


NENI 7

E gjithë veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne ligjin
Nr 8770 date 19.04.2001 dhe ne ligjin 7638 date
19.11,1992 " Per shoqerite tregtare"si edhe ne
legjislacionin ne pergjithesi te Republikes se
Shqiperise

NENI 8

Ky akt themelimi u redaktua dhe u nenshkrua ne 5
kopje e barazvefshme sot ne date 1`3 .06 2005 ...

ORTAKU I VETEM
SHKELQIM SELAMI



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
VLORE**

Notere Alketa Deshalla

Nr rep.....³⁵².....

Nr kol.....²⁵⁹.....


VERTETIM NENESHKRIMI

Sot ne date 13.06.2005 ne noteri perpara meje noteres **Alketa Ilirjan Deshalla** me seli prane Gjykates se Rrethit Vlore u paraqit personalisht :

SHKELQIM SELAMI i datelindjes 1967 lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar dhe juridike i njohur prej meje noteres personalisht .

Te cilet deklaruan se akti i bashkanjgjitur eshte nenshkruar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une noterja duke u bindur per kete si edhe per identitetin e tyre te plote e legalizoj ate .

**NOTERE
ALKETA DESHALLA**



3

STATUT I SHOQERISE TREGETARE “ SELAMI “ SH.P.K.

KREU 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

THEMELIMI

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ SELAMI “sh.p.k. themelohet ne perputhje me ligjin nr,7638 ,date 19.11.1992 “per shoqerite tregetare “ dhe te gjitha aktet e tjera neneligjore ne fuqi qe regullojne kete shoqeri .

Kjo shoqeri themelohet nga ORTAKU I VETEM

- SHKELQIM SELAMI I datelindjes 1967 lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore
- Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “SELAMI ” sh.p.k eshte themeluar ne date 13 .06 2005 ,sipas akt themelimit bashkangjitur
- Shoqeria “SELAMI ”sh.p.k. fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatën e shkalles se pare Tirane .
- Kjo shoqeri eshte Person Juridik dhe e zhvillon aktivitetin e tij ne perputhje me normat e legjislacionit Shqiptar ne Fuqi dhe akteve te saj themeluese si ky statut dhe akteve te saj themeluese si ky statut dhe akti i Themelimit qe i bashkohet dhe perben nje pjese te pandare te tije

Neni 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “SELAMI “ sh.p.k. do te jete “Kuzumbaba” Vlore

Aktiviteti i shoqerise shtrihet ne te tere tertorin e Republikës se Shqiperise si edhe jashte ketij teritori . shoqeria ka te drejte

te cele filiale ,agjensi , dege ose perfaqesi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise jashte saj , ne perputhje me legjislacionin shqiptar apo ate te vendeve te tjera ku do te hapen ato

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise "SELAMI "sh.p.k shtrihet ne fushat e meposhtme :

- Prodhimi i artikujve ushqimore industriale
- Ngritja e linjave te prodhimit per to
- Tregetimin magazinimin e mallrave industriale ushqimore , elektrike , hidraulike, veshmbathje , mobilieri, pjese kembimi te ndryshme , hidrosanitare , kancelari
- Import exportin artikujve si me siper
- Hapjen njesive per shitjen e tyre
- Hoteleri ,bar , restorante
- ndertim dhe r Rikostruksion banesash etj .
- lojra fati .
-

Shoqeria ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme per zhvillimin e veprimtarise se saje te parshikuar sa me siper.

NENI 4

Kohezgjatja e veprimtarise

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SELAMI "sh.p.k. do te ushtroje veprimtarin e e saj per nje periudhe kohore 20 vjecare .

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise mund te shtyhet apo shkruhet sipas dispozitave te parashikuara ne kete statut dhe konform kritereteve percaktuara nga legjislacioni shqiptar ne fuqi .

Mbyllja e veprimtarise do te behet automatikisht me perfundimin e afatit te parashikuar ose me vendimin e ORTAKUT TE VETEM .

KREU II

MARDHENIET EKONIMIKO FINANCIARE

NENI 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SELAMI " sh.p.k. perbehet nga te holla me vlere 100 000 (njeqind mije) leke qe i takon Teresisht ortakut te vetem ne mase 100% i ndarae ne 100 kuota me 1000 leke seicila

NENI 6

Transferimi i pjeseve te kapitalit

Kapitali themeltar apo pjese te caktuar te tij jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimnije apo personave te trete(shitje , dhurim) Me pelqimin e ortakut te vetem

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar kryhet gjithmone me akt Noterial .

NENI 7

Ndryshime te kapitalit

Te gjitha veprimtarite mbi kapitalin ,si zmadhimi , zvogelimi etj, behen vetem me miratimin e ortakut te vetem

Vleresimi i kapitalit themeltar ne natyre behet nga ortaku i vetem apo nga expert kontabel i emertuar nga kjo asamble

Kapitali teheltar dhe te gjitha ndryshimet dhe transferimet e pjesev te vecanta te tij mbahen dhe pasqyrohen ne nje regjister te vecante

NENI 8

Ndarja e fitimeve

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti ekonomik i shoqerise do ti takoje ortakut te vetem ne masen 1`00%

NENI 9

Bilanci financiar

Veprimtaria e shoqerise kryhet me qellimin e perfitimit ekonomik dhe pasqyrohet ne bilancin e vet vjetor qe duhet te perfundoje brenda muajit mars te vitit pasardhes .

Bilanci i aktivitetit vjetor financiar mund te behet nga ortakut i vetem ose nga ekspertet e emeruar prej tij .Administrimi Ne cdo rast rezultati i bilancit financiar i behen i njohur ortakut te vetem ndersa bilanci perfundimtar financiar shqyrtohet brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar .

NENI 10

Administrimi i fondeve

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit te vet ne perputhje me rregullat perkatese ne fuqi .

Perberja e fondeve ,burimet financiare te tyre ,etj caktohen me vendim te ortakut te vetem .

Administrimi i fondeve te Shoqerise kryhet nga administratori i shoqerise

Shoqeria disponon plotesisht te gjitha mjetet financiare te saj

KREU III

MARJA E VENDIMEVE

NENI 11

ORTAKU I VETEM

Organi Kryesor vendimares eshte ortakut i vetem

ADMNISTRIMI

NENI 12

ADMINISTRTORI

Shoqeria me pergjejgesi te kufizuar "SELAMI " sh.p.k administrohet nga Z. 'SHKELQIM SELAMI " i cili eshte edhe ortakut i kesaj shoqerije .

NENI 13

Kompetencat e Administratorit

Ne emer te shoqerise Administratori ka keto kompeteca :

- te mare pjese ne te gjitha ankandet qe kane lidhje me veprimtarine e shoqerise
- Te neneshkruaje cdo kontrate apo akt qe krijon mardhenie juridike me te tretet lidhur me veprimtarine e shoqerise
- Te perfaqesoje shoqerine ne strukturat shteterore apo gjyqesore ne ne te gjitha shkallet per cdo konflikt lidhur me veprimtarine e shoqerise
- Te mare persiper detyrime te ndryshme dhe te beje shkembime brenda veprimtarise se shoqerise .
- Shoqeria mer persiper te perballoje cdo pasoje qe vjen nga veprimet e administratorit ne zbatim te detyrave dhe kompetencave te tij .

NENI 14

Pergjegjesia e administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht dhe solidarisht ndaj shoqerise dhe ndaj personave te trete per veprimet e tyre ne shkelje te ligjit ,statutit, aktit te themelimit, ose per shkelje te renda me faj gjate kryerjes se detyrave dhe kompetencave te tyre .

NENI 15

Administratori i shoqerise ka te drejte te marre pjese ne shitje blerje , te hartoje kontrata te karaktereve te ndryshme , te tjetersoje pasuri te tundshme dhe te patundshme , te hape llogari rrjedhese prane bankave shqiptare ose te huaja etj .

KREU IV MARDHENIET E PUNES Neni 16

PUNEMARESIT

Per kryerjete aktivitetit te saj , shoqeria do te mare ne mardhenie pune cdo person qe gjykohet i nevojshem nga asambleja e ortakeve , ne baze te cilesive te tyre profesionale

Mardheniet e punes se shoqerise me punemaresit do te rregullohen me kontrata individuale pune , konform ligjeve dhe akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi .

Shoqeria mer persiper shlyerjen rregullisht te te gjitha detyrimeve perkatese qe rrjedhin nga punesimi si paga . sigurime shoqerore etj .

NENI 17

EKSPERTE KONTABEL

Ne ratet e nevojës , kur kerkohet nga ligji apo kur shihet e arsyeshme nga ortakut i vetem , kontrolli i veprimtarise se shoqerise kryhet nga nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar .

Te drejtat dhe detyrat dhe shperblimi i punes se eksperteve kontabel percaktohen ne mareveshjen e tyre me shoqerine .

KREU V

NENI 18

PUSHIMI I VEPRIMTARISE

Veprimtaria e shoqerise pushon me perfundimin e afatit te parashikuar ne statut , nese ortakut i vetem nuk vendos per zgjatjen e ketij afati

Veprimtaria e shoqerise mund te pushoje edhe para perfundimit te afatit me vendim te ortakut te vetem te shoqerise .

NENI 19

SHPERNDARJA E SHOQERISE

Shoqeria mund te shperbehet ne cdo kohe me humbjen e kapitalit , me pamundesine e justifikuar per ushtrimin e veprimtarise , me vendim . ortakut te vetem , apo me vertetimin e cdo shkakut tjeter ligjor qe sjell keto pasoja .

Ne rastin e shkrirjes se shoqerise , me vendim te ortakut te vetem do te caktoje likuidatorin .

Pasuria e mbetur e shoqerise, pas shlyerjes se detyrimeve te saj kundrejt te treteve dhe punonjesve te saj , do ti takoje ortakut te vetem

NENI 20f

DISPOZITA TE FUNDIT


Mardheniet juridike te shoqerise , te parregulluara nga ky statut , do te gjejne rregullimin e tyre ne dispozitat ligjore ne fuqi , ose ne shtesat apo modifikimit e nevojshme te ketij statuti .

NENI 21

Mosmareveshjet lidhur me veprimtarine qe ushtron shoqeria
SELAMI sh p.k.kur nuk zgjidhen me pajtim do te zgjidhen nga gjykata
competente.

Ky statut u hartua ne kater kopje dhe u nenshkrua me
yullnet te lire dhe te plote nga ortaku i vetem .

ORTAKU THEMELUES
SHKELQIM SELAMI



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Shkelqim Selami', written in a cursive style. The signature is positioned below the printed name.

